

**E nderuar zonja Kryetare
Te nderuar pjesmarres dhe te ftuar**

Ne emer te Kuvendit te Shqiperise dhe Kryetares Zonjes Jozefina Topalli desheroj te pershendes Autoritetin e Konkurences, drejtuesen e tij, komisioneret dhe punonjesit dhe ti uroj ne 5 vjetorin e krijimit te ketij institucioni kaq te rendesishem.

Krijimi dhe konsolidimi i ekonomise se tregut ne vendin tone nuk do te ecte ne drejtimin e duhur ne rast se nuk do te shoqerohej edhe me krijimin e institucioneve te cilat kryejne rolin e monitoruesit dhe mbikqyresit te zbatimit te rregullave.

Nje nga keto institucione roli i te cilit eshte i pa zevendesueshem ne funksionimin normal te ekonomise se tregut eshte institucioni i mbrojtjes se konkurences. Ne se tregu nuk do te rregullohej dhe mbikqyrej ne funksionimin e tij, pasojat do te ishin te tilla qe do shkaktonin deformime te medha te shoqeruara me kosto te larta financiare per individet dhe shoqerine.

Periudha 4 vjecare e qeverisjes se maxhorances se djathte ka treguar per vemendjen e madhe qe i eshte kushtuar funksionimit te nje tregu normal, persosjes se rregullave dhe legjislacionit si dhe zbatimit te nje qendrimi kundershues ndaj sjelljeve monopolizuese dhe shfrytezimit te pozites dominuese ne treg.

Plotesimi i reformes rregullatore dhe reduktimi ne maksimum i barrierave dhe pengesave administrative, ngritja e institucioneve te reja te regjistrimit dhe licensimit, permiresimi i legjislacionit baze te funksionit te tregjeve financiare, tregut bankar, sektoreve te tregetise me shumice dhe importit te mallrave, ndertimit, bujqesise, prokurimit te fondeve publike, licencimit, koncensioneve, reformimi i sistemit dhe administrates tatimore kane krijuar nje ekonomi me te hapur e me konkuruese.

Padyshim nje rol te rendesishem ne kete drejtim ka luajtur dhe do te luaje edhe ne te ardhmen Autoriteti i Konkurences. Megjithese nje institucion i ri, i ngritur nga themelet dhe ne kushtet e mungeses se experiences dhe tradites, ai ka mundur qe gradualisht te forcohet dhe te rrise autoritetin e tij.

Hetimet e ndermarra ne tregjete e telefonise celulare, ndertimit, perpunimit dhe tregjetimit te karburanteve, tregjeve financiare dhe te sigurimeve, energjise, sistemit bankar, etj tregojne per rolin gjithnje e me te madh qe ky institucion po luan si guardian i ekonomise dhe tregut te lire. Vetem gjate vitit 2008. Autoriteti i Konkurences ka dhene mbi 30 vendime ne mbrojtje te konkurences se lire ne sektore te ndryshem te ekonomise dhe liberalizimit te metejshem te saj.

Hartimi i politikave te konkurences, vleresimi i legjislacionit qe miratohet per te evituar ne te praktikat monopoliste, antikonkuruese dhe dominimit te tregut, hartimi i legjislacionit sekondar kane qene pjese e punes 5 vjecare dhe e kontributit te dhene nga ky institucion.

Sigurisht me shume pune kemi perpara dhe me shume perpjekje kerkohen ne te ardhmen. Vecanerisht ne permiresimin dhe persosjen e metodologjive dhe praktikave te monitorimit dhe mbrojtjes se mekanizmave te ekonomise se tregut.

Rritja e kapaciteteve te vete institucionit eshe nje sfide e madhe me te cilen duhet te perballeni sot dhe ne te ardhmen. Kompleksiteti i ekonomise, nderthurja midis sektoreve dhe degeve, globalizimi i pandalshem i saj i bejne proceset ekonomike dhe financiare me te nderlikuara dhe monitorimin dhe mbrojtjen e tregut me te veshtire. Shpejtesia e reagimit, shkurtimi i kohes se hetimit dhe rritja e cilesise se tij jane disa nga sfidat ne punen e Autoritetit te Konkurences ne te ardhmen.

Ne kete kuader bashkepunimi institucional dhe shkembimi i informacionit merr rendesi te vecante. Autoriteti i Konkurences do te mund ta kryente me mire punen e tij ne se te gjitha institucionet e tjera do ofronin bashkepunim dhe informacion te plote ne lidhje me ceshtjet qe shqyrtohen. Qendrimet mbeshtetese te sistemit gjyqesor marrin rendesi te posacme ne kontrollin dhe mbrojtjen e mekanizmave te tregut.

Shqiperia prej vitesh po punon intensivisht per tu bere pjese integrale e botes perendimore. Nenshkrimi i marreveshjes se stabilizim-asociimit me Bashkimin Europian dhe ratifikimi i saj nga te gjitha vendet anetare ka thelluar perspektiven europiane te Shqiperise.

Ky process kerkon pashmagesisht nje vemendje me te madhe ndaj politikave te konkurences, monitorimit dhe mbrojtjes se tregut. Perafrimi i legjislacionit dhe praktikave te vendit tone me ato te Komunitetit European ne fushen e konkurences mbetet nje tjeter sfide per Autoritetin e Konkurences.

Te nderuar pjesmarres,

Me lejoni qe edhe nje here ne emer te Kuvendit te Shqiperise ti uroj Autoritetin te konkurences festen e krijimit, te vleresoj punen e tij te deritanishme si dhe te shpreh besimin qe edhe ne te ardhmen do te permbushe misionin e tij ne ruajtje te shtyllave te ekonomise se tregut ne vendin tone.

Ju faleminderit.